

Në bazë të nenit 116 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.98/2012....275/2019) dhe nenit 4 të Rregullores për punën e Këshillit të Organizatës së regjistruar për fondin solidar dhe anëtarësimin nr.03-06/420 prej 04.07.2014, Këshilli në senacën e mbajtur më 13.12.2021 solli:

## V E N D I M

mbi përcaktimin e përkohshëm të lartësisë së mbajtjes për fondin solidar – ndihmë e pas vdekjes, anëtarësimin dhe lartësinë e pagesës së ndihmës së pas vdekjes

### Neni 1

Lartësia e mbajtjes për fondin solidar – ndihmë e pas vdekjes edhe më tutje mbetet në shumë prej 140,00 denarë për periudhën prej 01.01.2022 deri 30.06.2022 për shkak numrit të rritur të shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit, me qëllim të pagesës në kohë të ndihmës së pas vdekjes për anëtarët e familjes të pensionistit të ndjerë.

### Neni 2

Lartësia e pagesës së ndihmës së pas vdekjes e cila u paguhet anëtarëve të familjes së pensionistit të ndjerë arrin 30.000,00 denarë

### Neni 3

Për anëtarësim në shoqatë pensionistëve (taksë anëtarësie) lartësia e taksës së anëtarësisë arrin 30,00 denarë.

### Neni 4

Me këtë vendim pushon të vlejë Vendimi nr. 02-06/122-2 prej 21.05.2021 për lartësinë e mbajtjes për fond solidar – ndihmë e pas vdekjes, lartësinë e pagesës për ndihmën e pas vdekjes dhe anëtarësimin e shpallur në Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.105/2021.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa do të zbatohet me pagesën e pensioneve të janarit përfundimisht me pagesën e pensioneve të qershorit për vitin 2022.

Këshilli i Organizatës së regjistruar për  
Fondin solidar dhe anëtarësim

Kryetarë,  
Mentor Ooku